

VENDIM
Nr. 41, datë 4.8.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 25, DATË 18.4.2016, TË KOMITETIT PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE, PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhë vendimit nr. 25, datë 18.4.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit “Arsimi”, thirrja e parë, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, për vitin 2016”, bëhen ndryshime, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1

**NDRYSHIMI NË TABELËN 1, QË I BASHKËLIDHEJ VENDIMIT NR. 25, DATË
18.4.2016, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE**

Projektit nr. 22, në tabelën 1 të këtij vendimi, i ndryshon vlera e projektit dhe vlera e financimit për vitin 2016, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Kodi i programit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
22	Bashkia Malësi e Madhe	Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare “Preke Gjoni”, Bajzë	9120	45,450,800	9,090,160	36,360,640

Shënim:

1. Ky ndryshim përbën “korrektim” teknik të vlerës, për shkak të vendosjes “gabimisht” të vlerës së një projekti tjetër. Propozimi për ndryshimin e vlerës së plotë të projektit për këtë projekt, ka ardhur nga sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sportit), me shkresën 7821 prot., datë 2.8.2016.

2. Totali i vlerës së plotë të projektit si dhe vlera e financimit për vitin 2017, për tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 25, datë 18.4.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhet, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Kodi i programit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
TOTALI				1,972,906,203	966,317,861	1,006,588,341